



Duke u mbështetur në 12.2 shkronja d) dhe nenit 40.2 shkronja e dhe l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 1, 3, 13, 14, 15, 17 dhe 19 të Rregullores për përmbajtjen e simboleve komunale si dhe procedurën, mënyrën dhe kushtet për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve të tjera, nenit 10 nën 4 dhe nenit 40.2 nën pikën e 11 të Statutit të Komunës së Klinës, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e XI-të të rregullt për vitin 2016, të mbajtur më 29.12.2016 mori këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit për ndarje të Mirënjohjes "Frrok Gojani" në lëmin e arsimit të Komunës së Klinës

- I. Formohet Komisioni komunal për ndarje të Mirënjohjes "Frrok Gojani" në lëmin e Arsimit në Komunën e Klinës.
- II. Komisioni për ndarje të mirënjohjes si në pikën 1 të këtij Vendimi përbehet nga këta anëtarë:
 1. Rasim Millaku
 2. Vlora Tafilaj
 3. Hajdin Morina
 4. Kristina Lazri
 5. Nga Shoqëria Civile
- III. Komisioni për kryerjen e punës është kompetent që të punojë konform rregulloreve të fushës përkatëse, Rregullores komunale për përmbajtjen e simboleve komunale, si dhe procedurën, mënyrën dhe kushtet për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve të tjera si dhe Statutit të Komunës së Klinës.
- IV. Mirënjohje ju jepen në shenjë respekti atyre personaliteteve të cilët kanë dhënë kontribut të veçantë, të dallueshëm dhe të qenësishëm në fusha të ndryshme në të mirë të komunitetit.
- V. Kjo Mirënjohje nuk ka implikime financiare sipas nenit 3 paragrafi 5 i Rregullores komunale të sipërpërmendur.
- VI. Vendimi është i plotfuqishëm me miratim në Kuvendin e Komunës dhe 15 ditë pas protokollimit në MAPL konform nenit 18 të Rregullores për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të komunave Nr.01/2013.

Me Vendim të njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, anëtarët e komisionit, zyra për informim, Shërbimi për punë të Kuvendit dhe Arkivi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-126 2017
Klinë, më 12.01 2017

